



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Prodato Received/Delivery	26.09.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	6275/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1028/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1028/2023, të datës 26.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted], kundër organit të punësimit: Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1028/2023, e datës 26.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 28601/23, i datës 27.06.2023, i Komisionit të Pranimi në Komunën e Vushtrrisë.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] (tutje vetëm ankuesi), më datë 26.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1028/2023, kundër Vendimit me numër protokolli 28601/23, të datës 27.06.2023, të Komisionit të Pranimi në Komunën e Vushtrrisë, me pretendimet ankimore që procedura e konkursit për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Inspektor i Shërbimeve Publike, është përcjellë me shkelje ligjore përkatësisht së pyetjet e testit me shkrim kanë rrjedhë tek kandidatet para mbajtjes së testit, nuk është siguruar trajtim i barabartë i kandidateve dhe se ka pasur favorizime të kandidateve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.07.2023 ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Vushtrrisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 08.08.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 6020/2023, të datës 08.09.202, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5355/2023 të datës 26.07.2023, të parashtruar nga ankuesi, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Fotografimin e pyetjeve të testimit me shkrim siç pretendohet nga ankuesi, shkresë " kalendari që tregon se fotografia është bërë me datë 12.06.2023, Njoftimin për rezultatet e testimit me shkrim me numër protokoll 27303/23 të datës 20.06.2023, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; E-mailin e SIMBNJ të datës 15.06.2023; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me numër protokoll 28608/23 të datës 29.06.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Vendimin me numër protokoll 28601/23 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit pranë Komunës së Vushtrrisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Komunën e Vushtrrisë; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1028 të datës 08.08.2023 të Komunës së Vushtrrisë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpalljen e datës 19.04.2023 të Konkursit me numër reference RN00011477; Aplikacionin e datës 10.05.2023 të ankuesit së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës si : Diplomën me numër 1771 të datës 08.01.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomën me numër 1049 të datës 01.04.2016 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"; Certifikatën me numër 167 AE të datës 05-06.05.2012 të lëshuar nga "AESSH"; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 28.06.2011-17.01.2023; Vërtetim me numër 11/22 të datës 17.07.2022 të lëshuar nga Kolegji "Biznesi"; Vendimin me numër 111-1/19 të datës 01.03.2019, të lëshuar nga Kolegji "Biznesi"; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 27.12.2022 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Listën e kandidatëve në pritje për Konkursin me numër reference RN00011477; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe listën e kandidatëve të refuzuar për Konkursin me numër reference RN00011477; Njoftimin për verifikim paraprak me numër protokoll 24097/23, të datës 01.06.2023, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Njoftimin për verifikim paraprak përfundimtar me numër protokoll 24719/2, të datës 06.06.2023, për konkursin me numër reference RN00011477 ; Vendimin për formimin e Komisionit të Pranimit për Konkursin me numër reference RN00011477; Akt Emërimit të kandidatit me numër protokoll 861 të datës 01.02.2011; Akt Emërimit AE.nr.20-035/02-0033822/2, të datës 30.06.202; Akt Emërimit me AE.nr.20-035/01-0017003/22 të datës 01.04.2022; Akt Emërimit me numër protokoll 695, të datës 25.01.2011; Marrëveshjen me numër protokoll 02/23 të datës 05.01.2023 të lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe , Njoftimin për testin elektronik me shkrim të datës 09.06.2023 për kandidatet; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 20.06.2023; Njoftimin me numër protokoll 27303/23 të datës 20.06.2023 për rezultate e vlerësimit; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 22.06.2023 të ankuesit; Ankesën e datës 22.06.2023 të ankuesit drejtuar Komisionit për Pranim në Komunën e Vushtrrisë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur së Komuna e Vushtrrisë, me datë 19.04.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin e hapur me numër reference RN00011477, për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike 2, në Drejtorinë për Inspektive, Klasa "Profesional 1 , dy (2) vende pune, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Me tej sipas shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë, dhe së i njëjti i është nënshtruar testit më shkrim i mbajtur me 13.06.2023, me ç' rast ankuesi kishte arritur 56 pikë në testin me shkrim, ndërsa, Komisioni i pranimit lidhur me jetëshkrimin ka vlerësuar ankuesin me gjithsej 20 pikë, mirëpo, që ankuesi nuk ka hyr në intervistën më shkrim me arsyetimet si në ankesë.

Pas njoftimit të rezultateve të vlerësimit, të datës 20.06.2023, të Njësisë së Personelit të Komunës së Vushtrrisë, ankuesi me datë 22.06.2023 parashtron ankesë pranë Komisionit të Pranimit ndërsa, ky i fundit me Vendimin më numër protokoll 28601/23 të datës 27.06.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar, duke lenë në fuqi rezultate e vlerësimit të datës 20.06.2023.

Sipas konkursit me numër reference RN00011477, për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm -Inspektor i Shërbimeve Publike 2, klasa profesionale 1, si kërkesa të përgjithshme formale janë paraparë: *"Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës"*.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

- Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, ku me nenin 34 përcaktohet: 1. *Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi*

i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku neni 10 parasheh se : 1. Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitive, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët...” 2. Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.1. “Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj”; 2.2. “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”; 3. Kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të këtij neni, përfshijnë kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 8 të Ligjit dhe kërkesat e veçanta të pranimit në Grupin për të cilin zhvillohet konkurimi, të përcaktuara sipas dispozitave të Rregullores për klasifikimin e punëve në shërbimin civil. 4. Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vet deklaronte se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit. Neni 12 përcakton se: Përmbajtja e aplikacioneve 1. Aplikacioni përmban këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontaktit të dy (2) personave referues; 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion. Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurimit 1. Konkurimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 15 përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që

plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njësisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Në kuptim të kuadrit ligjor si dhe në mbështetje të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprime procedurale të procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00011477, nga shpallja e konkursit deri në fazën e jetëshkrimit, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar së kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara për pozitën e shpallur janë në pajtim me Shtojcën Nr.1/6 dhe Shtojcën Nr.2 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe se nuk vërehet ndonjë parregullsi procedurale lidhur me vlerësimin e testit me shkrim dhe vlerësimin e jetëshkrimit. Rrejdhimisht, sipas provave të çështjes, njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, ka përfshirë ankuesin në listën e ngushtë, si kandidat që ka plotësuar kushtet për aplikim duke vepruar në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Me tej, ankuesi ishte ftuar në vlerësimin sipas testimit më shkrim, me ç ‘rast i njëjti ka arritur numrin e nevojshëm (56 pikë) për të vazhduar tutje me këtë procedurë të rekrutimit, e mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit ka vijuar procedurën e pranimit me vlerësimin e jetëshkrimit të kandidateve përfshirë edhe ankuesin, duke e vlerësuar të njëjtin me gjithsej 20 pikë nga maksimumi i 20 pikëve, kështu që ankuesi akumulon 76 pikë, të mjaftueshme për të vazhduar me fazën e fundit të vlerësimit përkatësisht intervistën me gojë, e në të cilën vlerësim ankuesi me vullnet e tij nuk kishte marrë pjesë, kështu që sipas Kolegjit, njësia përgjegjëse ka vepruar sipas përcaktimeve ligjore të nenit 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili parasheh se: “2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, si dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, i cili përcakton se: “1.Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë”, andaj, rrjedhë se ankuesit nuk i wshtw cenuar ndonjë e drejtë në fazat e vlerësimit në të cilat ankuesi kishte marrë pjesë, përkatësisht në fazën e verifikimit paraprake, në fazën e testimit me shkrim për çka edhe vet ankuesi nuk ka ndonjë pretendim ankimor si dhe në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit, ngase, ankuesi ishte vlerësuar me maksimumin e pikëve siç përcaktohet me nenin 23 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që përendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit, se nuk ka pranuar të marrë pjesë në intervistën me gojë, pasi që një ditë para testit me shkrim, i kanë rënë në dorë pyetjet e testit me shkrim, me dyshimin se këto pyetje kanë dalë nga ndonjë anëtar i komisionit dhe se ka tendencë të qartë për favorizim të kandidatëve të caktuar, Kolegji i Këshillit vlerëson se ky pretendim ankimor tejkalon autorizimet kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, kurse pala ankuese udhëzohet për trajtim të këtyre pretendimeve në procedurë kompetente penale.

Bazuar në gjendjen faktike dhe bazën ligjore si me sipër, Kolegji i Këshillit ve në pah faktin së vendosja sipas ankesës A.nr.1028/23 të datës 26.07.2023, nuk nënkupton edhe vlerësimin meritor të procedurës së pranimit me numër reference RN00011477, pas fazës së jetëshkrimit, kështu që Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nen paragrafi 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132, paragrafi 2' të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1028/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.